



Lëviz dhe jetoj jetën time

Fondacioni Shqiptar Për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK) ofron shërbimin e Karrigeve me Rrota që nga viti 1996, sipas udhëzimeve dhe standarteve të rekomanduara nga Organizata Botërore e Shëndetësisë. Një Karrige me rrota, është një prej mjeteve ndihmëse më të përdorura për të përmirësuar lëvizshmërinë personale.

Rreth 10% e popullsisë globale, d.m.th. rreth 650 milion njerëz, janë me aftësi të kufizuara. 10% e tyre kanë nevojë për karrige me rrota. Kështu, 1% e popullsisë, apo 10% e popullsisë me aftësi të kufizuara, ka nevojë për karrige me rrota të tipologjive të ndryshme. Janë 65 milion njerëz në mbarë botën në nevojë për karrige me rrota. Në Shqipëri, mbi 6500 persona që janë pjesë e përfitimeve të skemës së individëve para e tetra plegjikë, janë në nevojë për karrige me rrota. Shumë të tjerë, me diagnoza apo gjendje të tjera shëndetësore, apo të pamundur të lëvizin për shkak të moshimit, kanë nevojë për karrige me rrota.

Për shumë njerëz, një karrige me rrota e përshtatshme, e mirëdizenjuar, mund të shërbejë si hap i parë drejt përfshirjes dhe pjesëmarrjes në shoqëri.

Karrige manuale janë ato që përdoren direkt nga përdoruesi, apo shtyhen nga një person tjetër. Një karrige me rrota është e përshtatshme kur :

- i përgjigjet nevojave të përdoruesit dhe kushteve të mjedisit;
- ofron siguri dhe është e qëndrueshme për një kohë të gjatë;
- ka përmasa të përshtatshme dhe mbështetëse të duhur për shpinën;
- është e gjendshme në vend/lokalisht: dhe
- mund të përftohet, mirëmbahet dhe merren shërbimet e duhura të qëndrueshme në vend.



Leave
No One
Behind

Karrige me rrota e dizenuar për një përdorues afatgjatë




Karriget me rrota të nivelit të ndërmjetëm ofrojnë mbështetje shtesë për qëndrimin. Avantazhet e shërbimit të ofruar për një karrige me rrota të ndërmjetme janë:

- Përmirësim i balancës, qëndrimit dhe stabilitetit
- Përmirësimi i komfortit
- Ndihmon në parandalimin dhe zhvillimin e plagëve
- Ndihmon në ngadalësimin apo parandalimin e zhvillimit të problemeve me qëndrimin në të ardhmen

Karriget me rrota të nivelit të ndërmjetëm mund të referohen për fëmijë të cilët:

- Kanë vështirësi të qëndrojnë drejt deri në moshën 1 vjeç;
- Nuk janë në gjendje të ecin vetë deri në moshën 2 vjeç;

Referimi i hershëm i fëmijëve në shërbimet e vlerësimit për karrige me rrota është i rëndësishëm për të siguruar lëvizshmërinë, pjesëmarrjen dhe zhvillimin e tyre.



Leave
No One
Behind

Karrige me rrota e dizenuar për një përdorues, i cili ka nevojë për mbështetje trupore



Sipas OBSH, praktika e ofrimit të shërbimit të karriges me rrota ndahet në tetë hapat si vijon:

- 1 Referimi
- 2 Vleresimi
- 3 Pershkrimi
- 4 Financimi dhe porositja
- 5 Pergatitja e produktit
- 6 Prova dhe pershtatja
- 7 Trajnimi i përdoruesit
- 8 Mirembajtja, riparimet dhe vizitat e rikontrollit.

1 Referimi

Referimi ka të bëjë me mënyrën se si përdoruesit kanë akses në shërbim. Sa më sipër, mund të jetë përmes "vetë-referimit", ku përdoruesit kontaktojnë në mënyrë të drejtpërdrejtë shërbimin, ose përmes "një rrjeti referimi", ku përdoruesit referohen nga një organizatë tjetër. Objektivi i praktikave të mira në referimet dhe praktikat është që të sigurojë që përdoruesit kanë akses në mënyrë të barabartë në shërbimin e karrigëve me rrota, të rrisë efikasitetin dhe produktivitetin e shërbimit dhe të minimizojë listën e pritjes.



Leave
No One
Behind

2 Vlerësimi

Objekti i një praktike të mirë vlerësimi është që të vlerësojë në mënyrë të saktë nevojat e çdo individi, me qëllim që të përshkruajë karrigen më të mirë të mundshme që është e vlefshme. Çdo përdorues kërkon një vlerësim individual, që kryhet nga një person apo persona me aftësitë e duhura. Vlerësimi duhet të jetë i gjithanshëm, të marrë parasysh stilin e jetesës, ambientin e banimit dhe kushtet fizike të përdoruesit. Është e rëndësishme që përdoruesi, dhe nëse është me vend edhe familja, të përfshihen plotësisht në vlerësim.



3 Përshkrimi

Përshkrimi është hapi i procesit që duhet të plotësojë nevojat e përdoruesit, sikurse identifikohen përmes vlerësimit, me karrigen më të mirë të mundshme që mund të jetë e vlefshme. Karriget me rrota, është e nevojshme të jenë të vlefshme në përmasa dhe lloje të ndryshme si edhe me opsione të ndryshme. Përshkrimi (ose përzgjedhja) përfaqëson një proces të përputhjes së nevojave të përdoruesit me karrigen më të mirë të mundshme. Forma e plotësuar jep një përshkrim të plotë të karrigës së kërkuar dhe përzgjedhur nga përdoruesi.



4 Financimi dhe porositja

Pas përshkrimit, është e mundur që të bëhet një vlerësim i kostos së produktit që rekomandohet. Për shumë nga shërbimet, është thelbësore të sigurohet financimi përpara se të bëhet porositja për pajisjen.

Karrigia e zgjedhur për përdoruesin porositet sa më parë të jetë e mundur. Kur nuk ka gjëndje, karriget me rrota duhet të porositen nga një ofrues i jashtëm ose të prodhohet nga një punishte e prodhimit të karrigeve me rrota, që zakonisht mban një rezervë të përmasave dhe llojeve të ndryshme të karrigeve me rrota.



Leave
No One
Behind



5 Përgatitja e produktit

Praktika në përgatitjen e produktit ka të bëjë me përgatitjen e karriges për përshtatje, përfshirë modifikime apo vendosje të komponenteve mbështetës për pjesë të ndryshme të trupit.

Modifikimet e karriges (ndryshime në skelet apo në komponente të karriges) kryhen nga personel me njohuritë dhe aftësitë e nevojshme, meqënëse çdo modifikim mund të ketë implikime strukturore apo funksionale.

Gjithë pajisja për lëvizje duhet të kontrollohet për cilësinë dhe sigurinë përpara se përdoruesi ta provojë atë.

6 Prova dhe përshtatja

Gjatë përshtatjes përdoruesi si edhe personeli klinik dhe teknik sigurohen se karrigia i përshtatet në mënyrë korrekte dhe e mbështet përdoruesin ashtu siç duhet.

Gjatë përshtatjes, përdoruesi dhe personeli kompetent sëbashku kontrollojnë që:

- karrigia me rrota është në përmasën e duhur;
- karrigia me rrota është përshtatur në mënyrën e duhur për përdoruesin;
- ndonjë modifikim apo komponent mbështetës është përshatur siç duhet; dhe
- karrigia i plotëson nevojat e përdoruesit për lëvizje dhe për të garantuar mbështetje për trupin si edhe minimizon rrezikun që përdoruesit të pësojnë deformime apo komplikacione dytësore.



7 Trajnimi i përdoruesit

Fushat kryesore të trajnimit të përdoruesit përfshijnë:

- si të transferohen në karrigen me rrota dhe nga karrigia me rrota;
- si të mirëmbajnë karrigen me rrota;
- lëvizje bazë me karrigen me rrota;
- si të qëndrosh në mënyrë të shëndetshme në karrige, përfshirë si të parandalosh hapjen e plagëve nga presioni i të qëndruarit ulur;
- si të kujdesesh për karrigen dhe për jastëkun, dhe nëse duhet, edhe si ta çmontosh dhe montosh karrigen me rrota, dhe
- kë të kontaktosh në rast se ke probleme me karrigen me rrota.



8 Mirembajtja, riparimet dhe vizitat e rikontrollit

Procesi i ndjekjes përfshin:

- sa mirë i ka shërbyer karrigia me rrota përdoruesit;
- ndonjë problem që mund të ketë patur përdoruesi në përdorimin e karriges me rrota;
- përshtatjen e karriges me rrota, në mënyrë të veçantë kontrollin se karrigia ofron mbështetje të mirë për trupin e përdoruesit;
- aftësitë e përdoruesit, duke identifikuar nevojat për trajnim të mëtejshëm,
- kushtet e karriges dhe nevojën për riparime apo përshtatje të tjera; dhe
- aftësinë e përdoruesit për tu kujdesur dhe për të mirëmbajtur karrigen me rrota dhe nëse ka nevojë për ndonjë trajnim tjetër të mëtejshëm.



Shpeshësia e ndjekjes do të varet nga nevojat individuale të përdoruesit.

FSHDPAK do të vijojë ofrimin e shërbimit të karrigeve me rrota, qofshin të nivelit bazë apo të ndërmjetëm. Së fundmi, falë mbështetjes së UNDP, ne po zgjerojmë rrjetin e referimit, trajnojmë specialistët dhe jemi sa më pranë njerëzve në nevojë anë e mbanë Shqipërisë. Këto aktivitete po ndërmerren në kuadrin e Programit të përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Leave no one Behind/Askush të mos mbetet pas" (LNB2), i cili mbështetet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).



Leave
No One
Behind

Ky material është përgatitur nga Fondacioni Shqiptar për të Drejtat e Personave me Aftësi të Kufizuara (FSHDPAK), në kuadër të Programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Askush të Mos Mbetet Pas/Leave No One Behind" (LNB), i cili zbatohet në bashkëpunim me Qeverinë Shqiptare dhe mbështetet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC).